



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:027309

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05842140

KPPP.nr. 548/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “MetBat” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810193368 dhe me seli në Malet e Krivovës, Drenas, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate Luljeta Jashari nga Prishtina kundër debitorit “Gekos” Sh.P.K, me nr. të biznesit 80191014, me seli në Veternik, Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Daut Rudi me zyre në Kaçanik, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 4/22 të datës 11.01.2022 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli të zyrës në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 11.06.2024 në të cilën prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me datë 20.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbarimore në mes të kreditorit “MetBat” Sh.P.K, kundër debitorit “Gekos” Sh.P.K, në lëndën sipas Urdhri Përmbarimor P.nr. 4/22 të datës 11.01.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, në shumën prej 18,058.25 EUR, për shkak të tërheqjes së propozimit për përmbarim nga kreditori për këtë pjesë të borxhit.
- II. REFUZOHET prapësimi i debitorit “Gekos” Sh.P.K. me seli në Prishtinë ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr. 4/22 të datës 11.01.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, për detyrimin në shumë prej 18,058.25 EUR.
- III. OBLIGOHET kreditori, që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore të shkaktuara pranë kësaj gjykate, t’ia paguaj debitorit “Gekos” Sh.P.K, shumën prej 558,20 EUR, dhe atë në afat prej shtatë (7) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi.

## A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “MetBat” sh.p.k, me datë 11.01.2022 ka lëshuar Urdhrin përmbaresimor P.nr. 4/22 me të cilin ka lejuar përmbaresimin në bazë të dokumentit faturë nr. 01/1/2021AS e datës 12.11.2021, duke urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 36,116.50 EUR (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë euro cent) me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbaresimore nën kërcënimin e përmbaresimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin për lejimin e përmbaresimit me arsyetimin se propozimi për përmbaresim nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 38 të LPP-së, pasi që fatura nuk është paraqitur në origjinal apo në kopje të vërtetuar. Tutje ka shtuar se deklarata e kreditorit se borxhi i debitorit është bërë i kërkueshëm është në kundërshtim me vet faturën objekt i këtij përmbaresimi, kjo pasi që në këtë faturë është përcaktuar qartë se nga shuma e tërësishme e faturuar prej 72,233.00 euro, pagesa e 25% të saj paguhet me datë 25.01.2022 ndërsa propozimi për përmbaresim është paraqitur me datë 11.01.2022, andaj edhe propozimi për përmbaresim është i parakohshëm, pasi që është lejuar përmbaresimi mbi një dokument pa skaduar afati për përmbushjen vullnetare. Tutje ka sqaruar se kontrata për asgjësimin e mbeturinave e datës 04.11.2021, procesverbali mbi asgjësimin e mbeturinave dhe procesverbali mbi inspektimin të datës 12.11.2021 janë nënshkruar që të gjitha nga A.D., i cili nuk është person i autorizuar i debitorit, kjo pasi që ky i fundit, që nga data 01.11.2021 nuk ka qenë në marrëdhënie pune me debitorin, fakt ky që vërtetohet nga komunikimi elektronik i datës 14.10.2021, përmes të cilit komunikim vërehet se A.D. ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij me efekt nga data 01.11.2021. Ka sqaruar tutje se kontrata e lidhur me kreditorin është në kundërshtim me ligjin edhe sa i përket përmbajtjes së saj, kjo pasi që pikën 2.3 të saj përcaktohet se “gjeneruesi është i obliguar që të bëjë klasifikim dhe sortime të produkteve për konsumimin e gjërave me afat të skaduar konform UA 10/2015” kjo pjesë e punës bëhet nga stafi farmaceutik i gjeneruesit”, ndërsa produktet e asgjësuar nuk kanë qenë fare produkte farmaceutike por lëngje të konsumit dhe se debitori fare nuk ka afarizëm me produkte farmaceutike. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të aprovohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbaresimit të anulohet.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke deklaruar se qëllimi i vetëm i debitorit është prolongimi i pagesës së borxhit ndaj kreditorit, kjo pasi që fatura e paraqitur me propozimin për përmbaresim, është në origjinal dhe është e nënshkruar dhe vulosur nga debitori si pranues i

shërbimit të asgjësimit të mbeturinave. Ka shtuar se pretendimet se kreditori ka paraqitur propozim të parakohshëm nuk qëndrojnë kjo pasi që debitori, pagesën prej 25% të borxhit ka pasur për ta paguar me datë 25.12.2021, dhe pasi që debitori nuk e ka përmbushur këtë pjesë, edhe marrëveshja për pagesën e borxhit me këste sipas faturës bie poshtë, ndërsa propozimi është parashtruar me datë 11.01.2022 andaj nuk mund të jetë i parakohshëm. Tutje ka sqaruar se është vet debitori që pranon se ka paguar 50% të vlerës së borxhit pas pranimi të faturës. Me kërkesë që Prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa Urdhri për lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr. 1954/22 të datës 23.10.2023 ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr. 4/22 të datës 11.01.2022.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 28/24 të datës 11.03.2024 ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit ashtu që ka anuluar aktvendimin KPPP.nr. 1954/22 të datës 23.10.2023 dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Gjykata, në rivendosje, me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimi të debitorit, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me datë 11.06.2024.

Debitori, përgjatë seancës dëgjimore, ka mbetur pranë te gjitha pretendimeve te theksuara ne prapësim dhe ka shtuar se meqenëse me Aktvendimin e Gjykatës se Shkallës se Dyte është anuluar aktvendimi KPPP.nr.1954/22 dt.23.10.2023 konsiderojmë se është anuluar edhe aktvendimi i po kësaj gjykate i datës 16 janar 2023 për caktimin e garancionit ne te holla, si parakusht për shqyrtimin e ankesës, e qe këtë shume debitori e ka paguar, ashtu qe këto mjete ne shume prej 36,116.50 EUR duhet t'i kthehen debitorit dhe atë ne afat prej 3 ditësh, afat i njëjtë i caktuar për pagesën e garancionit. Shpenzimet e kërkuara gjate kësaj procedure i ka kërkuar dhe atë shumen prej 624.00 EUR ne emër te përpilimit të prapësimi, shumen prej 624.00 EUR ne emër te përpilimit te ankesës, si dhe shumen prej 270.00 ne emër te përfaqësimit në seancë dëgjimore si dhe shumen prej 30.00 EUR në emër te taksës.

Kreditori, përgjatë seancës dëgjimore ka shtuar se pas pranimi të vendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës se Dyte, me te cilin është aprovuar si e bazuar ankesa e debitorit, e shfrytëzojmë te drejtën e rregullimit te propozimit për përmbarim, ashtu qe sipas faturës dhe kontratës origjinale, 50% e shumes totale është paguar ditën e faturimit, 25% është dashur te paguhet me date 25.12.2021, dhe pjesa e fundit prej 25% ka pasur afatin e fundit te pagesës me

date 25.01.2022. Meqenëse propozimi është bere me date 11.01.2022, datë kjo kur si kërkesë e arritshme është bërë vetëm vlerë prej 25% e faturës e cila është dashur të paguhet deri më datë 25.12.2012, ka rregulluar propozimin për përmburim duke kërkuar vetëm shumën prej 18,058.25 EUR, kamatën prej 8% , e cila është bere e arritshme me date 25.12.2021 si dhe të gjitha shpenzimet e përmburimit. Ndërsa ka shtuar se pas vendosjes nga gjykata, kreditori do paraqes kërkesë të veçantë që t'i sigurohet fatura origjinale ne mënyrë qe t'i bëhet e mundur që të paraqes propozimin e ri për pjesën e mbetur prej 25% e cila është dashur te përmbushet deri me datë 25.01.2022, e për të cilën pjesë të borxhit edhe është anuluar vendimi nga Dhomat e Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate përmes aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 28/24 të datës 11.03.2024, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmburimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pjesërisht i bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmburimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmburim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmburim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se fatura nr. 01/1/2021AS e datës 12.11.2021 në bazë të së cilës është lejuar përmburimi i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe fatura është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si në faturë.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura nr. 01/1/2021AS e datës 12.11.2021 është dorëzuar në origjinal në përputhje me nenin 37 të LPP-së, andaj e njëjta është e përshtatshme për përmbardim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbardimit.

Në ndërlidhje me këtë, në seancën dëgjimore të datës 13.06.2024 kreditori ka tërhequr propozimin për përmbardim sipas faturës nr. 01/1/2021AS në vlerë prej 18.058.25 EUR e cila ka pasur afat pagese me datë 25.01.2022, kjo për shkak të kjo shumë nuk ka qenë e maturuar në kohën e dorëzimit të propozimit për përmbardim me datë 11.01.2022, vërejtje kjo e konstatuar nga Dhomat të Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, duke deklaruar se lidhur me pjesën e tërhequr të borxhit do të inicioj procedurë të veçantë përmbardimore.

Në prezencë të këtyre rrethanave, meqenëse kreditori ka tërhequr pjesërisht propozimin për përmbardim duke kërkuar që urdhri për lejimin e përmbardimit të mbetet në fuqi vetëm sa i përket shumës prej 18.058.25 EUR e cila është bërë e arritshme me datë 25.12.2021, pra para inicimit të propozimit për përmbardim, gjykata, në mbështetje të nenit 42 par.1 të LPP-së i cili parasheh se *“Propozimi për përmbardim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbardimore pa pëlqimin e debitorit”* lidhur me par.2 të këtij neni i cili përcakton që *“Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbardim organi përmbardues e përfundon përmbardimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht”* vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, që të përfundohet pjesërisht procedura përmbardimore sipas urdhrin përmbardimor P.nr. 4/22 të datës 11.01.2022, në vlerën prej 18,058.25 EUR.

Ndërsa, meqenëse pjesa tjetër e borxhit sipas faturës nr. 01/1/2021AS në vlerë prej 18,058.25 EUR është dashur të paguhet deri më datë 25.11.2021, dhe si e tillë është bërë e arritshme para inicimit të propozimit për përmbardim, dhe duke qenë se debitori nuk ka ofruar asnjë provë që kjo pjesë e borxhit është përmbushur, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, që urdhrin përmbardimor P.nr. 4/22 të datës 11.01.2022 për vlerën prej 18,058.25 EUR ta lë në fuqi.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet tjera të debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet në tërësi urdhri për lejimin e përmbardimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore të shkaktuara pranë kësaj gjykate, gjykata në mbështetje të nenit 17 të LPP-së, iu referua përshtatshmërisht nenit 452 par.2 të LPK-së i cili parasheh se *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”* lidhur me nenin 456 par.1 i cili parasheh që *“Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t’ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit”*.

Në këtë drejtim, duke qenë kreditori ka tërhequr pjesërisht propozimin për përbarim në shumën prej 18,058.25 EUR, e cila shumë paraqet prej 50% të shumës së lejuar me urdhrin për përbarim, gjykata vendosi që në proporcion me propozimin e tërhequr, debitorit t’i njihen 50% të shpenzimeve të shkaktuara pranë kësaj gjykate. Kësisoj, referuar tarifës së OAK, nr. tarifor 6 lidhur me shpenzimet e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë, në ndërlidhje me nr. tarifor 9 të saj, gjykata gjeti se debitorit i janë shkaktuar shpenzime përbarimore dhe atë në emër të përpilimit të prapësimit shuma prej 408.00 EUR, në emër të përpilimit të ankesës shuma prej 408.00 EUR, në emër të përfaqësimit në seancë dëgjimore shuma prej 270.40 EUR, si në emër të taksës gjyqësore për ankesë shumën prej 30.00 EUR, apo në total shumën 1,116.40 EUR, ashtu që në proporcion me suksesin e arritur, gjykata ia njohi debitorit 50% të lartësisë së këtyre shpenzimeve, saktësisht shumën prej 558,20 EUR.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 548/24, datë 20.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.